



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT  
KORÇË  
VENDIM

Nr 12 Datë 13. 2. 2009

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË  
VARTËSISË PËR VITIN 2009**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «**Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009**», në zbatim të ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr 9936 dt 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», Ligjit nr 10025 dt. 27.12.2008 " Për buxhetin e shtetit të vitit 2009", V.K.M nr. 369 dt. 13.06.07 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore", Udhëzimi nr. 21 datë 18.09.2007 "Për zbatimin e V.K.M nr 369 datë 13.06.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore", V.K.M nr. 557 dt. 16.08.06 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 167, dt. 29.03.2006 të Këshillit të Ministrave "Për disa ceshtje në zbatim të Ligjit 7703 dt. 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Repuplikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe Ligjit 7870 dt. 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", V.K.M. nr 1619 dt 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive Vendore për efekt page dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore", Udhëzim nr 2dt. 12.01.2009 i Ministrisë së Financave «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009», Udhëzimi nr 37 dt. 20.11.2008 «Për përdorimin e të ardhurave nga proçesi i legalizimit», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë e Buxhetin e Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009.
2. Me propozim të këshilltarëve u vendos që plani i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2009 të rritet me 800 mijë lekë dhe konkretisht taksa mbi ndërtesën të rritet me 500 mijë lekë dhe taksa e reklamës të rritet me 300 mijë lekë. Si përfundim plani i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2009 nga 434,443 mijë lekë bëhet 435,243 mijë lekë.
3. Me propozim të këshilltarëve u vendos që vlera prej 800 mijë lekë të kalojë me këtë destinacion :

- 400 mijë lekë në fondin e projekteve të Bashkisë.
- 100 mijë lekë në fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sekretarin e Këshillit Bashkiak.
- 100 mijë lekë në fondin e investimeve për paisje.
- 100 mijë lekë shpenzime operative blerje bazë materiale për shpërblimin e ekipit të para të rinjve në Klubin e Futbollit.
- 100 mijë lekë shpërblim ekipit të volejbollit të të rriturve në Klubin Shumësportësh për performancë të mirë dhe arritje të objektivave.

4. Të miratojë planin e të ardhurave për vitin 2009 gjithsej **647.453 mijë lekë** të detajuar si më poshtë:

000/lek

Emertimi	Vlera
TRANSFERTE E PAKUSHTEZUAR	186,488
PLANIFIKIMI I TE ARDHURAVE 09	435,243
TE ARDHURA INSTITUCIONE 09	25,722
<b>TOTALI</b>	<b>647,453</b>

5. Të miratojë planin e shpenzimeve sipas ndarjeve ekonomike për vitin 2009 gjithsej **647.453 mijë lekë** sipas zërave të mëposhtëm:

000/lek

NR	EMERTIMI	Viti 2009
1	Shpenzime per paga	165,350
2	Shpenzime per sigurime shoqerore	34,100
3	Shpenzime operative (mallra, materiale)	285,190
4	Shpenzime te tjera	31,466
5	Investime	131,347
<b>TOTALI</b>		<b>647,453</b>

6. Të miratojë normativat e harxhimit të: energjisë elektrike, të ujit, të telefonave fiks të instaluar në Bashki, të karburantit për makinat e Bashkisë, gjeneratorin dhe kaldajën, normativat e harxhimit për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes, sipas tabelave të paraqitura në «Buxheti i Bashkisë për vitin 2009».

7. Të miratojë përdorimin e telefonit celular të Kryetarit të përlogaritur sipas V.K.M 343 datë 11.07.2002 pika 2, Udhëzimi i M.F. nr 10. dt. 24.10.2002 "Për administrimin e shpenzimeve për telefoninë e lëvizshme në përdorim të zyrtarëve publike" në vlerën **15 mijë lekë** në muaj.

8. Me propozim të këshilltarëve u vendos që fondi prej 672,000 mijë lekë, i planifikuar për blerjen e kartave të celularit, do të përdoret për shlyerjen e

shpenzimeve të telefonisë celulare ndaj operatorit duke ruajtur limitin e përcaktuar në tabelën e paraqitur në planin e buxhetit 2009. Shlyerja do të bëhet nga Drejtoria e Financës sipas faturave.

**9.** Të miratohet detajimi i projekteve të paraqitura sipas pasqyrave nr. 1,2,3 dhe 4 me këtë strukturë buxhetore:

Pakesohet	00	01110 05	6040000	- 11,971,500 lekë Bashkia
Shtohet	00	01110 05	6020000	+ 4,860,000 lekë Bashkia
Shtohet	00	01110 05	6030000	+ 840,000 lekë Bashkia
Shtohet	00	01110 05	6040000	+ 1,000,000 lekë bashkia
Shtohet	00	01110 05	6060000	+ 600,000 lekë Bashkia
Shtohet	00	01110 05	2310000	+ 290,000 lekë Bashkia
Shtohet	00	09120 05	6020000	+ 693,000 lekë Arsimi 9vj
Shtohet	00	09120 05	6060000	+ 1,138,500 lekë Arsimi 9vj
Shtohet	00	09120 05	2310000	+ 500,000 lekë Arsimi 9vj
Shtohet	00	08250 05	6020000	+ 950,000 lekë Qendra e Kultures
Shtohet	00	08140 05	6020000	+1,100,000 lekë Klubi Shsportesh

**10.** Të miratohet detajimi i investimeve për vitin 2009 sipas pasqyrës nr. 5

**11.** Bazuar në ligjin 9376 dt. 21.04.2005 «Për Sportin», të miratohet trajtimi ushqimor për Klubin e Futbollit «Skënderbeu», për vitin 2009, si dhe për Klubin Shumësportësh «Skënderbeu».

**12.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.

**13.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari**  
**Raimonda NASE**

*Raimonda Nase*